

Niveli i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në institucionet publike

Raport mbi rezultatet
e anketës



Niveli i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në institucionet publike

Raport mbi rezultatet
e anketës

TITULLI:

Niveli i zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në institucionet publike - Raport mbi rezultatet e anketës

AUTOR:

Lëvizja FOL

VITI I BOTIMIT:

DHJETOR, 2024

WEBSITE:

www.levizjafol.org

ADRESA:

Andrea Gropa nr.35, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2024. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky dokument është realizuar si pjesë e projektit "Human Rightivism", në kuadër të nismës "Gardianët e të dhënave: Forcimi i Politikave të Privatësisë dhe Ndërgjegjësimit në Institucionet Publike" që udhëhiqet nga Lëvizja FOL. Projekti implementohet nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF) me mbështetjen e Ambasadës së Suedisë në Kosovë. Pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të SIDA-s ose qeverisë suedeze.

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive _____	6
1. Hyrje _____	16
2. Metodologjia _____	17
3. Korniza ligjore e mbrojtjes së të dhënave personale ____	18
4. Pyetjet e parashtruara përmes anketave _____	20
5. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga institucionet qendrore _____	23
6. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga komunat _____	35
7. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga agjencitë ekzekutive _____	49
8. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga institucionet e pavarura _____	63
9. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga universitetet publike _____	75
10. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga ndërmarrjet publike _____	85
11. Pasqyra e ankeseve dhe masave të marrura nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (janar 2022 – nëntor 2024) _____	95
12. Rekomandime _____	98
Shtojca _____	99

Përmbledhja ekzekutive

Ky raport ka për qëllim skanimin e situatës aktuale të mbrojtjes së të dhënave personale në institucionet publike të Kosovës, si dhe të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar përmes kërkesave për qasje në dokumente publike drejtuar të gjitha institucioneve publike. Në këtë raport janë të përfshira të dhënat e pranuar nga 105 institucione publike.

Gjatë hulumtimit janë identifikuar disa probleme thelbësore në kuptim të respektimit të obligimeve që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sikurse mungesa e caktimit të zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale nga një pjesë e konsiderueshme e institucioneve shtetërore, mungesa e hartimit/publikimit të politikave të privatësisë, mungesa e trajnimeve të zyrtarëve, numri i ulët i institucioneve që kanë nxjerrë protokolle për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, si dhe rregulloren për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Të dhënat e mbledhura nga institucionet publike tregojnë se, përderisa disa institucione kanë bërë avancim në këtë aspekt, ende mbetet një boshllëk i konsiderueshëm në zbatimin e standardeve të kërkuara ligjore.

Gjetjet mbi zbatimin e kërkesave ligjore nga të gjitha institucionet publike janë paraqitur në pikat e mëposhtme, duke reflektuar sfidat dhe arritjet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

- Nga 105 institucione, sa i janë përgjigjur kërkesave për qasje në dokumente publike të dërguar nga Lëvizja FOL, 92 institucione e kanë emëruar tashmë zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkohë, 13 institucione të tjera ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Krahas progresit të arritur në caktimin e zyrtarëve përgjegjës nga pjesa më e madhe e institucioneve publike, ky rezultat tregon qartë se mbetet ende punë për t'u bërë për të siguruar zbatimin e plotë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nga institucionet publike.

01 A e ka caktuar institucioni juaj zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale?



Figura 1. Numri i institucioneve publike që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

-
- Pjesa më e madhe e institucioneve publike, përkatësisht 82 sosh, nuk i kanë hartuar dhe publikuar politikatat e privatësisë, duke mos përmbushur një nga kërkesat thelbësore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Këtë obligim e kanë kryer vetëm 23 institucione publike, gjë që thekson nevojën urgjente për forcimin e zbatimit të ligjit dhe ndërgjegjësimin e institucioneve për rëndësinë e transparencës dhe mbrojtjes së privatësisë së qytetarëve.

02 A i ka hartuar dhe publikuar institucioni juaj politikatat e privatësisë



Figura 2. Numri i institucioneve publike që i kanë hartuar/publikuar politikatat e privatësisë dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

- Vetëm 34 institucione kanë pohuar se zyrtarët e tyre kanë ndjekur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale. Sipas përgjigjeve të tyre, këto trajnime ishin organizuar kryesisht nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (*tani e tutje: AIP*). Ndërsa pjesa prej 71 institucionesh, kanë raportuar se zyrtarët e tyre asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në trajnime të tilla.

Mungesa e trajnimeve tregon një mungesë të qartë të përgatitjes së duhur të stafit përkatës të institucioneve për të trajtuar në mënyrë efektive çështjen e mbrojtjes së të dhënave, duke theksuar nevojën për programe të detyrueshme trajnimi. Përgatitja dhe trajnimi i duhur janë kritike për të siguruar që institucionet të veprojnë në përputhje me ligjin, si dhe për të mbrojtur privatësinë e qytetarëve në mënyrë efektive.

03 A ka ndjekur trajnime zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale në institucionin tuaj?




Figura 3. Numri i institucioneve publike, zyrtarët e të cilave kanë zhvilluar apo jo trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale.

- 11 nga 105 institucionet që janë përgjegjur në kërkesat për qasje në dokumente publike kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërsa 94 institucione tjera kanë thënë se ende nuk e kanë nxjerrë këtë rregullore.

Ky rezultat vë në pah dobësitë e institucioneve në mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave personale, si dhe tregon nevojën imanente për veprime të mëtejshme nga institucionet për të siguruar përputhshmëri me standardet e sigurisë dhe për të mbrojtur të dhënat e qytetarëve.

04 A ka nxjerrë institucioni juaj Rregulloren për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale?



Figura 4. Numri i institucioneve publike që kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe i atyre që ende nuk e kanë nxjerrë këtë rregullore.

- Sa i përket ankesave nga qytetarët për shkeljen/mbrojtjen e të dhënave personale, 4 institucione kanë konfirmuar se kanë pasur ankesa të tilla. Ndërsa shumica dërmuese, përkatësisht 101 institucione publike, kanë mohuar të kenë pasur ndonjëherë ankesa nga qytetarët për shkaqe të tilla.

Në një mënyrë, ky rezultat mund të tregojë mungesë të vetëdijesimit të qytetarëve për mundësinë/mënyrën e paraqitjes së ankesave, apo një mungesë të besimit të qytetarëve rreth mënyrës së trajtimit të ankesave. Kjo nënvizon nevojën për ngritjen e vetëdijes së publikut se kanë të drejtë të paraqesin ankesa të tilla, si dhe forcimin e mekanizmave për të adresuar ankesat e lidhura me mbrojtjen e të dhënave.

05 A ka pasur institucion juaj ankesa nga qytetarët për shkeljen e të dhënave personale?



Figura 5. Numri i institucioneve publike që kanë pasur ose jo ankesa nga qytetarët për shkeljen/mbrojtjen e të dhënave personale.

- Periudha të përcaktuara për ruajtjen e të dhënave personale kanë konfirmuar se kanë 33 institucione publike. Ndërsa pjesa prej 72 institucionesh të tjera kanë mohuar të kenë afate të tilla për ruajtjen e këtyre të dhënave, të përcaktuara qartë në institucionet e tyre.

Ky rezultat reflekton mangësitë në menaxhimin e të dhënave personale, që mund të ketë për pasojë ruajtjen e panevojshme të të dhënave. Mungesa e qartësisë për periudhat e ruajtjes rrezikon të shkelë të drejtat e qytetarëve dhe thekson nevojën për përmirësimin e praktikave të menaxhimit të të dhënave në institucionet publike.

06 A ka ndonjë periudhë të ruajtjes së të dhënave personale të përcaktuar qartë në institucionin tuaj?




Figura 6. Numri i institucioneve publike që kanë të përcaktuara ose jo periudha të ruajtjes së të dhënave personale.

- Protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme kanë pohuar se kanë 27 institucione publike. Ndërsa 78 institucione publike kanë thënë se ende nuk kanë nxjerrë protokolle të tilla në institucionet e tyre.

Sikurse në rastin e mungesës së periudhave dhe afateve të ruajtjes së të dhënave, edhe në këtë rast tregohet mangësi serioze në mbrojtjen e të dhënave më të ndjeshme të qytetarëve, duke rritur rrezikun për keqpërdorime dhe shkelje të privatësisë. Rrjedhimisht, rezultatet e tilla reflektojnë nevojën urgjente për përmirësimin e procedurave të menaxhimit dhe forcimin e masave për sigurinë e të dhënave në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore.

07 A ka ndonjë protokoll specifik për menaxhimin e të dhënave senzitive në institucionin tuaj?




Figura 7. Numri i institucioneve publike që kanë ose jo protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme.

- Sa i përket të drejtës për të kërkuar këshilla/udhëzime mbi çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale nga AIP, nga përgjigjet e institucioneve shihet se këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar vetëm 37 institucione publike. Ndërsa pjesa prej 68 institucionesh kanë mohuar të kenë drejtuar kërkesa të tilla në këtë institucion.

Kjo tregon një nivel të ulët të ndërgjegjësimit dhe angazhimit nga ana e institucioneve për të kërkuar asistencë në çështjet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave nga institucioni kompetent. Rrjedhimisht, mungesa e kërkesave për këshilla në AIP nënvizon nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë që kanë institucionet në këtë fushë.

08 A ka drejtuar institucioni juaj kërkesa për këshilla në AIP?




Figura 8. Numri total i institucioneve publike që kanë dërguar ose jo kërkesa për këshilla në AIP.

- Sa i përket shfrytëzimit të së drejtës për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale, përkatësisht për të ushtruar “të drejtën për t’u harruar”, nga përgjigjet e institucioneve shihet se 2 institucione kanë pasur kërkesa të tilla nga qytetarët. Ndërsa pjesa prej 103 institucioneve kanë mohuar të kenë pasur kërkesa të tilla nga qytetarët.

Edhe në këtë rast, mungesa e kërkesave për fshirjen e të dhënave mund të tregojë mungesë të ndërgjegjësimit tek qytetarët se kanë mundësi të shfrytëzojnë këtë të drejtë ligjore, si dhe thekson nevojën për ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për çështjet që ndërlidhen me fushën e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

09 A kanë dërguar qytetarët ndonjë kërkesë për fshirjen e të dhënave personale në institucionin tuaj?



Figura 9. Numri i institucioneve publike tek të cilat qytetarët kanë dërguar ose jo kërkesa për fshirjen e të dhënave personale.

- Në periudhën janar 2022 - nëntor 2024, AIP ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankeshash lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht 380 sosh, me fokus të veçantë në përpunimin e të dhënave pa pëlqim, shkeljet nga sistemi i kamerave të vëzhgimit, si dhe shpërndarja e të dhënave personale pa autorizim.
- Gjatë kësaj periudhe, AIP ka marrë gjithsej 639 vendime lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ka shqiptuar 15 gjopa kundërvajtëse për shkelje të ligjit me vlerë totale prej 261,000.00 euro.

1. Hyrje

Në epokën e sotme digjitale, mbrojtja e të dhënave personale është bërë një prej sfidave më të mëdha për subjektet publike dhe private. Rritja e zhvillimit të teknologjisë më ritëm të shpejtë, po përcjellët edhe me rritjen e cënueshmërisë së të dhënave personale. Ky realitet i ri kërkon nga institucionet qasje më të avancuar dhe të përgjegjshme në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Pavarësisht përparësive që ofron digjitalizimi në efikasitetin e shërbimeve publike, ai gjithashtu krijon hapësira të reja në abuzime të mundshme dhe në rreziqet që lidhen me privatësinë e individëve. Kjo e bën të domosdoshme një qasje të koordinuar dhe të plotë për t'u siguruar që të dhënat personale mbrohen në mënyrë efektive.

Në këtë kontekst, institucionet publike janë akterët kryesor që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë të garantojnë sigurinë e informacioneve që i mbledhin dhe i përpunojnë nga qytetarët. Zbatimi rigoroz i ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, është thelbësor për të ruajtur besimin e publikut në shërbimet e institucioneve, si dhe për të siguruar një mjedis të sigurt dhe transparent. Në Kosovë, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dizajnuar për të krijuar standarde të qarta për të gjitha institucionet publike dhe private, duke siguruar që të gjitha të dhënat e qytetarëve të trajtohen me kujdes dhe konfidencialitet.

Ky raport përfaqëson një përpjekje të rëndësishme për të krijuar një pasqyrë të plotë të nivelit të përmbushjes së detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale në Kosovë. Ai synon të ofrojë një analizë të hollësishme mbi implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në institucionet publike, si dhe duke theksuar nevojën për përmirësime në fushat ku mangësitë janë më të dukshme.

Përveç kësaj, raporti do të ndihmojë në identifikimin e sfidave me të cilat institucionet përballen, duke ofruar gjithashtu rekomandime të vlefshme në përmirësimin mëtejshëm të zbatimit të ligjit. Duke pasur parasysh rrezikun e mbrojtjes së privatësisë në epokën e teknologjisë së informacionit, rekomandimet e raportit synojnë të udhëheqin institucionet drejt një qasje më pro aktivë dhe efektive në mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve.

Ky raport do të shërbejë edhe vetë Agjencisë për Informim dhe Privatësi të ketë një pasqyrë të qartë dhe reale mbi nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në vend, duke evidentuar progresin e arritur dhe sfidat që duhet adresuar në të ardhmen.

2. Metodologjia

Ky raport hulumtues është bazuar në të dhënat e mbledhura përmes anketës së zhvilluar me institucione publike, e cila synonte të vlerësoj nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në institucionet publike të Kosovës.

Të dhënat janë mbledhur duke përdorur një pyetësor të hartuar posaçërisht për të arritur objektivat e këtij hulumtimi. Pyetësi paraprakisht është ndarë me Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe pastaj është dërguar në mënyrë elektronike tek të gjitha institucionet publike të Kosovës, përmes kërkesave për qasje në dokumente publike. Struktura e pyetësorit është hartuar për të mbuluar një gamë të gjerë çështjesh që lidhen me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe pyetjet e parashtruara nuk kufizohen në ndonjë periudhë të caktuar kohore. Fillimisht kërkesat janë dërguar me 10 korrik 2024, dhe të njëjtat janë ridërguar disa herë për të siguruar përgjigjet e sa më shumë institucioneve publike. Kërkesat për qasje në dokumente publike janë dërguar tek 151 institucione publike, ndërsa përgjigje kemi pranuar nga 105 sosh.

Pyetësi përfshinte pyetje të hapura dhe të mbyllura, të cilat synonin të vlerësonin aspektet kyçe të mbrojtjes së të dhënave personale. Pyetësi i përdorur për hulumtim gjendet në [Shtojcë](#) të këtij raporti.

Rezultatet e anketës së realizuar përbëjnë bazën për vlerësimet dhe rekomandimet e ofruara në këtë raport, duke synuar të japin pamjen e qartë të gjendjes aktuale të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në institucionet publike të Kosovës.

Një aspekt i rëndësishëm i metodologjisë ishte kategorizimi i të dhënave të mbledhura në varësi të llojit të institucioneve ku janë grumbulluar, përkatësisht në: institucione qendrore, institucione lokale, agjenci ekzekutive, institucione të pavarura, universitete publike dhe ndërmarrje publike. Ky kategorizim ka ndihmuar gjithashtu në identifikimin e dallimeve dhe ngjashmërive në zbatimin e ligjit ndërmjet këtyre kategorive të institucioneve.

Në përfundim, raporti përmban edhe një listë rekomandimesh, implementimi i të cilave do të ndihmonte në përmirësimin e të mbrojtjes së të dhënave personale në vend.

3. Korniza ligjore e mbrojtjes së të dhënave personale

3.1 Korniza ligjore ndërkombëtare

Korniza ligjore e mbrojtjes së të dhënave personale, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, është themeluar mbi bazën e standardeve të njohura ndërkombëtare dhe të drejtave themelore të njeriut.

Fillimisht, në kuadër të sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), në nenin 12 të **Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut** garantohet liria nga ndërhyrjet në privatësinë, familjen, shtëpinë dhe korrespondencën.

Në këtë kontekst, edhe **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** në nenin 8 të saj e siguron të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në pajtim me ligjin dhe për qëllime të përcaktuara qartë, siç janë siguria kombëtare, siguria publike ose mirëqenia ekonomike e vendit.

Ndërsa, instrumenti themelor ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale në Bashkimin Evropian është **Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave** (General Data Protection Regulation), e cila u miratua nga Parlamenti Evropian me 14 prill të vitit 2016 dhe filloj të zbatohet me 25 maj të vitit 2018 në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

GDPR vendosi standarde rigorozë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe u jep individëve të drejta të gjera mbi të dhënat e tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për korrigjim dhe fshirje të të dhënave. Kjo rregullore zëvendësoi Direktivën e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të vitit 1995, duke përmirësuar dhe përforcuar standardet e mbrojtjes së privatësisë në përputhje me zhvillimet e teknologjisë.

3.2 Korniza ligjore kombëtare

Në Kosovë, e drejta e privatësisë është e garantuar me **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**¹, përkatësisht me nenin 36 të saj, e cila garanton respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera, dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo dispozitë krijon një bazë kushtetuese të fortë për mbrojtjen e të dhënave personale në vend.

1 GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Për të konkretizuar dhe detajuar këtë mbrojtje, në shkurt të vitit 2019, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratohet **Ligjin nr. 06/L082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**², hartimi i të cilës është bërë në përputhje me Rregulloren 2016/679 të Parlamentit Evropian (GDPR). Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat për përpunimin e të dhënave personale, duke përfshirë kërkesat për pëlqimin e individëve, të drejtat e subjekteve të të dhënave, detyrimet e kontrollorëve dhe përpunuesve të të dhënave, si dhe masat e sigurisë që duhet të merren për të mbrojtur të dhënat.

Ky ligj paraqet një komponent kyçe në sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë dhe synon të mbrojë privatësinë e individëve duke vendosur standarde të larta për trajtimin e të dhënave personale nga institucionet publike dhe private në vend.

Në anën tjetër, edhe AIP si institucion kompetent në mbrojtjen e të dhënave personale, ka nxjerrë një varg aktesh nënligjore për të qartësuar dhe përmirësuar praktikën e mbrojtjes së të dhënave personale. Këto akte janë hartuar për të ofruar udhëzime të detajuara dhe për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Disa nga këto akte përfshijnë:

- ✓ Politikat e Privatësisë – Drafti për Shkollë;
- ✓ Udhëzues për Përdorimin e Sistemit të Vëzhgimit me Kamerë për Kontrolluesit e të Dhënave;
- ✓ Udhëzues për Përpunimin e të Dhënave Personale për Qëllim të Marketingut të Drejtpërdrejtë;
- ✓ Udhëzues mbi përdorimin e karakteristikave biometrike në sektorin privat;
- ✓ Doracak për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- ✓ Udhëzues për regjistrat e aktiviteteve të përpunimit të të dhënave personale;
- ✓ Pëlqimi i prindërit/kujdestarit për fotografimin dhe incizimin e fëmijut në Kopsht/Shkollë.

Këto dokumente janë projektuar për të adresuar nevojat specifike, duke përfshirë përdorimin e kamerave për monitorim, përpunimin e të dhënave për marketing, përdorimin e teknologjive biometrike dhe mbrojtjen e të dhënave në sektorin edukativ.

Rrjedhimisht, këto akte nënligjore paraqesin një kornizë të strukturuar të sistemit të mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë, duke siguruar që përpunimi dhe menaxhimi i të dhënave të bëhet në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes dhe transparencës.

2 GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 6 / 25 SHKURT 2019, PRISHTINË, LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

4. Pyetjet e parashtruara përmes anketave

Pyetësi i dërguar tek institucionet përmes kërkesave për qasje në dokumente publike (*i cili është vendosur edhe në **Shtojcë** të këtij raporti*), përfshinte pyetje që kishin të bëjnë me çështjet e mëposhtme:

→ **Caktimi i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale** – Neni 37 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) përcakton se kontrolluesi³ dhe përpunuesi⁴ duhet të caktojë një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha rastet e mëposhtme:

- nëse përpunimi kryhet nga një organ publik (përveç gjykatave që veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore);
- nëse aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga veprimet përpunuese që në saje të natyrës, objektit dhe/ose qëllimit të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt dhe sistematik të subjektit të të dhënave në një shkallë të gjerë;
- nëse aktivitetet kryesore të kontrolluesit ose të përpunuesit përbëhen nga përpunimi në një shkallë të gjerë të kategorive të veçanta dhe të dhëna personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale.

→ **Hartimi dhe publikimi i politikave të privatësisë** - Politikat e privatësisë janë mjete kryesor për të siguruar se të dhënat personale të individëve ruhen dhe trajtohen me kujdes. Këto politika përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve lidhur me informacionin e tyre personal.

Publikimi i politikave të privatësisë në ueb-faqet zyrtare të institucioneve publike ofron një shkallë të lartë të transparencës, duke e bërë të qartë për publikun se si institucioni merr, përpunon dhe ruan të dhënat personale të individëve. Ky veprim ndihmon në sigurimin e besimit të publikut dhe në lehtësimin e tyre për të kuptuar se si institucionet i trajtojnë dhe i ruajnë të dhënat e tyre.

→ **Rregullorja për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale** - Çdo institucion duhet të hartojë Rregulloren për masat e sigurisë, që përfshin procedurën dhe politika për mbrojtjen e të dhënave personale.

³ Sipas ligjit, kontrolluesi i të dhënave është çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.

⁴ Sipas ligjit, çdo person fizik ose juridik, nga sektori publik ose privat, i cili përpunon të dhëna personale për dhe në emër të kontrolluesit të të dhënave.

- **Ankesat e qytetarëve për mbrojtje të të dhënave personale** - Siç është përcaktuar në nenin 52 të LMDhP-së, çdo individ që ndjen se të dhënat e tij personale po përpunohen në mënyrë të paligjshme, ka të drejtë të paraqesë ankesë në AIP. Ky mekanizëm është një mundësi për të kërkuar mbrojtje pa nevojën e ndërmarrjes së masave të tjera administrative ose ligjore.

Konform dispozitave ligjore, AIP është e obliguar të informoj ankuesin mbi progresin dhe rezultatin e ankesës së tij. Po ashtu, duhet të ofrojë informacion për mundësinë e përdorimit të mjeteve të tjera gjyqësore për të kërkuar mbrojtje shtesë, sipas nenit 54 të ligjit përkatës.

- **Kërkesat për këshilla nga institucionet/subjektet kërkuese drejtuar AIP-së** - Një ndër kompetencat e AIP-së, të përcaktuara me LMDhP, është edhe dhënia e këshillave dhe udhëzimeve institucioneve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Ky këshillim është i rëndësishëm për të ndihmuar në zbatimin e duhur të praktikave dhe procedurave të sigurta.

- **Protokollet specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme** - Institucionet duhet të zhvillojnë protokolle të detajuara për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, për të siguruar që këto të dhëna trajtohen dhe ruhen në përputhje me standardet e larta të mbrojtjes dhe sigurie.

- **Kërkesat e qytetarëve për fshirjen e të dhënave personale (e drejta për t'u harruar)** - Qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë fshirjen e të dhënave personale që nuk paraqesin ndonjë interes publik, e njohur ndryshe si "*e drejta për t'u harruar*". Institucionet duhet të menaxhojnë kërkesat e kësaj natyre në përputhje me ligjin dhe të sigurojnë që të dhënat e kërkuara të fshihen në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Për secilën prej pyetjeve të parashtruara, FOL ka kërkuar sqarime shtesë dhe të dhëna më të detajuara për të siguruar një kuptim të plotë dhe të saktë në mbrojtjen e të dhënave personale.

5.

**Zbatimi i ligjit për
mbrojtjen e të
dhënave personale
nga institucionet
qendrore**

5. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga institucionet qendrore

Institucionet qendrore përpunojnë një sasi të madhe të dhënash personale të qytetarëve, duke përfshirë të dhëna të ndjeshme, si ato financiare, shëndetësore dhe sociale. Këto të dhëna janë të lidhura ngushtë me qytetarët dhe siguria e tyre paraqet një detyrë të rëndësishme për këto institucione, për të ruajtur besimin e publikut dhe për të respektuar të drejtat e qytetarëve.

Sa i përket përgjigjeve të pranuar në kërkesat e dërguara, nga 18 institucione qendrore të Kosovës, vetëm 2 institucione nuk janë përgjigjur në këto kërkesa.⁵

5.1 Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

Sa i përket caktimit të zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, nga 16 institucionet qendrore që i janë përgjigjur kërkesave të dërguara, 13 prej tyre i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa 3 prej tyre (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) këtë nuk e kanë bërë ende.

Kjo tregon se, ndonëse pjesa më e madhe e institucioneve qendrore e kanë përmbushur këtë obligim, tri institucione të rëndësishme nuk kanë vepruar akoma konform kërkesave ligjore, duke ngritur shqetësime për sigurinë dhe menaxhimin e të dhënave personale që këto institucione përpunojnë.

Në lidhje me sqarimet shtesë që FOL ka kërkuar për institucionet që nuk i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kanë sqaruar se pas ristrukturimit të vendeve të punës në këtë ministri nuk është paraparë pozita "Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Pra kjo tregon një mospërputhje me kërkesat ligjore dhe nxjerrë në pah mungesën e prioritizimit të mbrojtjes së të dhënave në këtë ministri.

⁵ Institucionet e vetme të cilat nuk janë përgjigjur në pyetësin e dërguar janë: **Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës**, si dhe **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**.

Ndërkohë, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kanë thënë se nuk posedojnë informacion se përse këta zyrtarë nuk janë caktuar, ndërsa nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kanë sqaruar se ish-zyrtari përgjegjës për arsye personale është kërkuar të largohet nga caktimi i zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe aktualisht pritet të caktohet zyrtari tjetër.

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur institucionet të cilat i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato që ende nuk e kanë kryer këtë obligim.



 E kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale	 Nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale
1 Zyra e Presidentes	1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2 Kuvendi i Kosovës	2 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
3 Zyra e Kryeministrit	3 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
4 Ministria e Mbrojtjes	
5 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	
6 Ministria për Komunitete dhe Kthim	
7 Ministria e Shëndetësisë	
8 Ministria e Punëve të Brendshme	
9 Ministria e Zhvillimit Rajonal	
10 Ministria e Ekonomisë	
11 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	
12 Ministria e Drejtësisë	
13 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	

Tabela 1. Numri i institucioneve qendrore që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe i atyre që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

5.2 Hartimi dhe publikimi i politikave të privatësisë

Vetëm 2 institucione qendrore kanë hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë (Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zyra e Kryeministrit), ndërsa një pjesë e konsiderueshme e institucioneve, përkatësisht 14 sosh, nuk i kanë hartuar/publikuar ende këto politika.

Ky fakt tregon qartë mungesën e përkushtimit të shumicës së institucioneve qendrore për të vepruar konform kërkesave ligjore. Pjesa më e madhe e institucioneve qendrore që nuk e kanë përmbushur këtë obligim kanë thënë se nuk ka pasuar asnjë nismë nga AIP në lidhje me hartimin e këtyre politikave dhe se të gjitha veprimet që ndërlihdën me këtë aspekt i ndërmarrin konform Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur institucionet të cilat i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë dhe ato që ende nuk e kanë kryer këtë obligim.

 Kanë hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë	 Nuk kanë hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë
1 Zyra e Kryeministrit	1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
2 Ministria e Punëve të Brendshme	2 Kuvendi i Kosovës
	3 Zyra e Presidentes
	4 Ministria e Mbrojtjes
	5 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
	6 Ministria për Komunitete dhe Kthim
	7 Ministria e Shëndetësisë
	8 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
	9 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	10 Ministria e Ekonomisë
	11 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
	12 Ministria e Drejtësisë
	13 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
	14 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Tabela 2. Numri i institucioneve qendrore që i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë dhe i atyre që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

5.3 Trajnimi i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale

Vetëm 4 institucione kanë konfirmuar se zyrtarët e tyre kanë ndjekur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale (Ministria për Komunitete dhe Kthim; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Zyra e Presidentes), ndërsa 12 institucionet tjera kanë thënë se zyrtarët përgjegjës të tyre nuk kanë zhvilluar trajnime në lidhje me këtë fushë.

Institucionet që kanë konfirmuar që kanë ndjekur trajnime kanë sqaruar se trajnimet e ndjekura kanë qenë të organizuara nga AIP.

Fakti se zyrtarët e vetëm 4 institucioneve qendrore kanë zhvilluar trajnime në lidhje me këtë fushë, tregon një situatë mjaftë shqetësuese dhe nënvizon nevojën për një angazhim më të madh nga ana e institucioneve për të siguruar që të gjithë zyrtarët të kenë njohuritë e nevojshme për të mbrojtur të dhënat personale dhe për të vepruar në përputhje me ligjet në fuqi.

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur institucionet, zyrtarët e të cilave kanë zhvilluar trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ato të cilët nuk kanë zhvilluar trajnime të tilla.

 Kanë zhvilluar trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale	 Nuk kanë zhvilluar trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale
1 Zyra e Presidentes	1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
2 Ministria e Punëve të Brendshme	2 Kuvendin e Republikës së Kosovës
3 Ministria për Komunitete dhe Kthim	3 Zyra e Kryeministrit
4 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4 Ministria e Mbrojtjes
	5 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
	6 Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
	7 Ministria e Shëndetësisë
	8 Ministria e Financave, Punës dhe Transferve
	9 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	10 Ministria e Ekonomisë
	11 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
	12 Ministria e Drejtësisë

Tabela 3. Numri i institucioneve qendrore, zyrtarët e të cilave kanë mbajtur trajnime ose jo në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

5.4 Nxjerrja e Rregullores për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Asnjë nga institucionet qendrore nuk ka nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Ky rezultat është tregues mjaftë i rëndësishëm për nevojën për përmirësim në fushën e menaxhimit dhe sigurisë së të dhënave personale në radhët e institucioneve qendrore të Kosovës. Institucionet duhet të krijojnë një infrastrukturë të fortë të sigurisë për të garantuar që të dhënat janë të mbrojtura nga qasjet e paautorizuara, apo nga keqpërdorimi i tyre në çfarëdo lloji mënyre.

Nga sqarimet e pranuar nga këto institucione, është thënë që nuk ka pasur ndonjë iniciativë nga AIP për të hartuar këto dokumente, ndërsa në një nga përgjigjet, përkatësisht **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka deklaruar se nuk e shohin të nevojshme hartimin e kësaj rregulloreje, duke argumentuar se e zbatojnë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.**

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur institucionet qendrore të cilat ende nuk kanë nxjerrë rregullore të tilla.



 Kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale	 Nuk kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale
	1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	2 Kuvendin e Republikës së Kosovës
	3 Zyra e Kryeministrit
	4 Ministria e Mbrojtjes
	5 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
	6 Ministria për Komunitete dhe Kthim
	7 Ministria e Shëndetësisë
	8 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
	9 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	10 Ministria e Ekonomisë
	11 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
	12 Ministria e Drejtësisë
	13 Zyra e Presidentes
	14 Ministria e Punëve të Brendshme
	15 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
	16 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Tabela 4. Numri i institucioneve qendrore që kanë nxjerrë apo jo Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

5.5 Ankesat e qytetarëve për shkeljen e të dhënave personale

Të gjitha institucionet qendrore kanë raportuar se asnjëherë nuk kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale në institucionet e tyre.

Ndonëse mungesa e ankesave për shkeljen e të dhënave personale mund të shihet si pozitive, kjo gjithashtu nënkupton se institucionet duhet të investojnë më shumë në fushata informuese për të siguruar që qytetarët të dinë se si t'i mbrojnë të dhënat e tyre personale në rast se konsiderojnë se e drejta e tyre e privatësisë është shkelur.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur lista e institucioneve qendrore të cilat nuk kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale.



 Kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale	 Nuk kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale
	1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	2 Kuvendi i Republikës së Kosovës
	3 Zyra e Kryeministrit
	4 Ministria e Mbrojtjes
	5 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
	6 Ministria për Komunitete dhe Kthim
	7 Ministria e Shëndetësisë
	8 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
	9 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	10 Ministria e Ekonomisë
	11 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
	12 Ministria e Drejtësisë
	13 Zyra e Presidentes
	14 Ministria e Punëve të Brendshme
	15 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
	16 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Tabela 5. Numri i institucioneve qendrore që kanë pasur ose jo ankesa për mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarët.

5.6 Periudha e ruajtjes së të dhënave personale

Nga përgjigjet e institucioneve qendrore në lidhje me atë se a kanë periudha të caktuar të ruajtjes së të dhënave personale, del në pah një dallim i qartë mes institucioneve që kanë përcaktuar qartë këto periudha dhe atyre që ende nuk e kanë bërë këtë. Vetëm 5 institucione qendrore (*Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*) kanë deklaruar se kanë politika të qarta për periudhat e ruajtjes së të dhënave personale.

Nga ana tjetër, 11 institucionet tjera kanë thënë se nuk kanë ndonjë periudhë të ruajtjes së të dhënave personale të përcaktuar qartë në institucionet e tyre. Kjo gjendje krijon pasiguri për qytetarët dhe personat e prekur nga përdorimi i të dhënave të tyre, pasi mungesa e afateve të përcaktuara mund të çojë në keq menaxhim të të dhënave, ruajtjen e tepërt të tyre dhe rrezikun e shkeljes së privatësisë.

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur institucionet që kanë të përcaktuara periudha të qarta për ruajtjen e të dhënave personale dhe ato që nuk kanë përcaktuar afate të tilla.



 Kanë të përcaktuara periudha të ruajtjes së të dhënave personale	 Nuk kanë të përcaktuara periudha të ruajtjes së të dhënave personale
1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1 Ministria e Ekonomisë
2 Ministria e Punëve të Brendshme	2 Ministria e Mbrojtjes
3 Zyra e Kryeministrit	3 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
4 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	4 Ministria për Komunitete dhe Kthim
5 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5 Ministria e Shëndetësisë
	6 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	7 Kuvendi i Republikës së Kosovës
	8 Ministria e Drejtësisë
	9 Zyra e Presidentes
	10 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
	11 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Tabela 6. Numri i institucioneve qendrore që kanë pasur të përcaktuara ose jo periudha të ruajtjes së të dhënave personale.

5.7 Protokollet specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme

Vetëm 8 institucione qendrore kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme (p.sh., të dhënat shëndetësore, të dhënat financiare etj.), ndërsa 8 institucione të tjera kanë thënë se nuk kanë protokolle të tilla.

Mungesa e protokolleve specifike mund të çojë në ekspozim të paqëllimshëm të të dhënave, apo keq menaxhim të të dhënave të ndjeshme. Rrjedhimisht, institucionet që ende nuk kanë protokolle të tilla, është e domosdoshme që të hartohen dhe zbatohen politika të veçanta për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, të bazuara në standardet më të mira të mbrojtjes së të dhënave.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur renditja e institucioneve qendrore që kanë protokolle të veçanta për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme dhe ato që nuk kanë protokolle të tilla.

 Kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme	 Nuk kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme
1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1 Ministria e Ekonomisë
2 Ministria e Punëve të Brendshme	2 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
3 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	3 Ministria për Komunitete dhe Kthim
4 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	4 Ministria e Shëndetësisë
5 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5 Ministria e Drejtësisë
6 Ministria e Mbrojtjes	6 Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës
7 Ministria e Zhvillimit Rajonal	7 Zyra e Kryeministrit
8 Kuvendi i Republikës së Kosovës	8 Ministria i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Tabela 7. Numri i institucioneve qendrore që kanë nxjerrë protokolle specifike për ruajtën e të dhënave personale të ndjeshme dhe ato që ende nuk kanë nxjerrë protokolle të tilla.

5.8 Kërkesat për këshilla drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Vetëm 7 institucione qendrore (*Zyra e Presidentes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve*) kanë raportuar se kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP. Ndërkohë, 9 institucione tjera kanë thënë se nuk kanë dërguar këshilla në AIP në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo tregon se një pjesë e këtyre institucioneve kanë treguar angazhim për t'u konsultuar me AIP-në, që është organi kompetent për të ofruar udhëzime mbi çështjet e privatësisë. Kërkimi i këshillave nga AIP reflekton përpjekje për të siguruar pajtueshmëri me rregullat dhe standardet e mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe për të parandaluar shkelje të mundshme. Kjo praktikë përforcon gjithashtu transparencën dhe llogaridhënien në procesin e menaxhimit të të dhënave personale brenda këtyre institucioneve.

Është thelbësore që të gjitha institucionet qendrore të përqafojnë një qasje proaktive për të kërkuar udhëzime dhe mbështetje nga AIP në mënyrë që të sigurojnë përputhshmëri me ligjin dhe mbrojtje më të mirë të privatësisë së qytetarëve.

Nga sqarimet e ofruara nga institucionet që kanë konfirmuar se kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP, në përgjithësi kanë thënë se me AIP-në komunikojnë në vazhdimësi sa herë që paraqiten kërkesa nga qytetarët, institucionet apo OJQ-të për qasje në dokumente publike, të cilat dokumente mund të përmbajnë të dhëna personale.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur lista e institucioneve që kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP dhe ata që nuk kanë dërguar kërkesa të tilla.

 Kanë dërguar kërkesa për këshilla tek AIP	 Nuk kanë dërguar kërkesa për këshilla tek AIP
1 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
2 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	2 Kuvendi i Republikës së Kosovës
3 Ministria e Punëve të Brendshme	3 Zyra e Kryeministrit
4 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4 Ministria e Mbrojtjes
5 Ministria e Drejtësisë	5 Ministria e Ekonomisë
6 Zyra e Presidentes	6 Ministria për Komunitete dhe Kthim
7 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	7 Ministria e Shëndetësisë
	8 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	9 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Tabela 8. Numri i institucioneve qendrore që kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP dhe ato që nuk kanë kërkuar udhëzime të tilla.

5.9 Kërkesat e qytetarëve për fshirjen e të dhënave personale

Të gjitha institucionet qendrore kanë raportuar se nuk kanë pranuar kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale.

Kjo, në njëërën anë, mund të tregoj mungesë të informacioneve tek qytetarët për mundësinë e parashtrimin të kërkesave për fshirjen e të dhënave të qytetarëve, ndërsa në anën tjetër, tregon për një mungesë të përgjithshme të fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit publik nga ana e institucioneve përkatëse, të cilat kanë për detyrë t'i informojnë qytetarët mbi të drejtat e tyre dhe procedurat që mund të ndjekin për t'i mbrojtur ato.

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur të gjitha institucionet qendrore, të cilat nuk kanë pasur kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale.

 Kanë pranuar kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale	 Nuk kanë pranuar kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale
	1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
	2 Kuvendin e Republikës së Kosovës
	3 Zyra e Kryeministrit
	4 Ministria e Mbrojtjes
	5 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
	6 Ministria për Komunitete dhe Kthim
	7 Ministria e Shëndetësisë
	8 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
	9 Ministria e Zhvillimit Rajonal
	10 Ministria e Ekonomisë
	11 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
	12 Ministria e Drejtësisë
	13 Zyra e Presidentes
	14 Ministria e Punëve të Brendshme
	15 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
	16 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Tabela 9. Numri i institucioneve qendrore, të cilat nuk kanë pranuar kërkesa për fshirjen e të dhënave personale të qytetarëve.

6.

**Zbatimi i ligjit
për mbrotjen e të
dhënave personale
nga komunat**

6. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga komunat

Duke marrë parasysh rolin e komunave në ofrimin e shërbimeve publike dhe administrimin e çështjeve lokale të qytetarëve, mbrojtja e të dhënave personale është thelbësore për të ruajtur privatësinë e qytetarëve dhe për të parandaluar abuzimet dhe keqpërdorimet.

Komunat, gjithashtu, janë institucionet më të afërta me qytetarët, e shpeshherë përpunojnë të dhëna të ndjeshme, si informacionet e gjendjes civile, pronës, e të dhëna të tjera që lidhen drejtpërdrejtë me përditshmërinë e qytetarëve. Rrjedhimisht, këto institucione duhet të kenë politika të qarta dhe mekanizma mbikëqyrjeje për t'u siguruar që këto të dhëna janë të mbrojtura në tërësi.

Nga 38 Komunat e Kosovës, 26 prej tyre janë përgjegjës në pyetësin e dërguar nga Lëvizja FOL⁶.

6.1 Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

Në lidhje me përmbushjen e këtij obligimi të paraparë me ligj, nga 26 komunat të cilat i janë përgjegjës pyetësit, 23 prej tyre i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkaq këtë obligim nuk e kanë kryer vetëm 3 prej këtyre komunave.

Ky rezultat tregon se pjesa dërmuese e komunave kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi sa i përket caktimit të zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke siguruar kështu mbrojtjen e të dhënave personale për qytetarët.

Në sqarimet e kërkuara nga FOL, nga Komuna e Mitrovicës së Jugut kanë thënë se aktualisht janë në proces të emërimit të këtij zyrtari; nga Komuna e Fushë Kosovës kanë thënë se është ngarkuar me punë një zyrtarë që nuk është emëruar ende me vendim; ndërsa nga Komuna e Deçanit nuk kanë ofruar asnjë sqarim.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen komunat të cilat i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ata që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

⁶ Komunat të cilat nuk janë përgjegjës në pyetësin e dërguar janë: **Komuna e Pejës; Komuna e Gjilanit, Komuna e Malishevës; Komuna e Suharekës; Komuna e Klokotit; Komuna e Mitrovicës së Veriut; Komuna e Zubin Potokut; Komuna e Leposaviqit; Komuna e Zveçanit; Komuna e Shtërpcës; Komuna e Ranillugut dhe Komuna e Parteshit.**



E kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale



Nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

1	Komuna e Prishtinës	1	Komuna e Fushë Kosovës
2	Komuna e Istogut	2	Komuna e Mitrovicës së Jugut
3	Komuna e Junikut	3	Komuna e Deçanit
4	Komuna e Lipjanit		
5	Komuna e Skenderajt		
6	Komuna e Obiliqit		
7	Komuna e Kaçanikut		
8	Komuna e Klinës		
9	Komuna Hani i Elezit		
10	Komuna Dragash		
11	Komuna e Mamushës		
12	Komuna e Gjakovës		
13	Komuna e Ferizajt		
14	Komuna e Novobërdës		
15	Komuna e Prizrenit		
16	Komuna e Shtimes		
17	Komuna e Kamenicës		
18	Komuna e Podujevës		
19	Komuna e Drenasit		
20	Komuna e Rahovecit		
21	Komuna e Vitisë		
22	Komuna e Vushtrrisë		
23	Komuna e Graçanicës		

Tabela 10. Numri i komunave që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

6.2 Hartimi dhe publikimi i politikave të privatësisë

Vetëm 7 komuna i kanë hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë, ndërsa 19 prej tyre nuk i kanë hartuar/publikuar ende këto politika.

Këto rezultate tregojnë, pra, se shumica e komunave në Kosovë ende nuk e kanë përmbushur obligimin për të hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë, që është një komponent thelbësor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve.

Disa prej komunave kanë sqaruar se shkak i mos hartimit/publikimit të politikave të privatësisë është mungesa e resurseve njerëzore, ndërsa pjesa më e madhe e tyre kanë thënë se për çështje të tilla veprojnë në bazë të ligjit, dhe nuk ka pasur kërkesë të tillë nga AIP.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen komunat të cilat i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë, dhe ata që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.


 I kanë hartuar/ publikuar politikat e privatësisë	 Nuk i kanë hartuar/ publikuar politikat e privatësisë
1 Komuna e Mitrovicës së Jugut	1 Komuna e Prishtinës
2 Komuna e Skenderajt	2 Komuna Fushë Kosovës
3 Komuna Hani i Elezit	3 Komuna e Junikut
4 Komuna e Dragashit	4 Komuna e Shtimes
5 Komuna e Ferizajt	5 Komuna e Istogut
6 Komuna e Novobërdës	6 Komuna e Lipjanit
7 Komuna e Drenasit	7 Komuna e Kaçanikut
	8 Komuna e Klinës
	9 Komuna e Obiliqit
	10 Komuna e Mamushës
	11 Komuna e Gjakovës
	12 Komuna e Prizrenit
	13 Komuna e Deçanit
	14 Komuna e Kamenicës
	15 Komuna e Podujevës
	16 Komuna e Rahovecit
	17 Komuna e Vitisë
	18 Komuna e Vushtrrisë
	19 Komuna e Graçanicës

Tabela 11. Numri i komunave që i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

5 Autoriteti i Aviacionit Civil	5 Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
6 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	6 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
7 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	7 Organi Shqyrtues i Prokurimit
8 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës	8 Agjencia Kosovare e Privatizimit
	9 Zyra e Rregullatorit për Energji
	10 Akademia e Drejtësisë
	11 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
	12 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
	13 Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës
	14 Komisioni i Pavarur i Mediave
	15 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Tabela 33. Numri i institucioneve të pavarura që kanë përcaktuar periudha të ruajtjes së të dhënave personale, dhe ato që nuk kanë përcaktuar periudha të tilla.

8.7 Protokollet për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme

Vetëm 3 institucione të pavarura kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, ndërsa 20 institucione tjera kanë thënë se nuk kanë protokolle të tilla.

Këto rezultate tregojnë një mungesë të madhe të protokolleve specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme në institucionet e pavarura. Prandaj, institucionet duhet të marrin masa të menjëhershme për të hartuar dhe zbatuar këto protokolle, duke garantuar mbrojtjen e duhur të të dhënave të ndjeshme dhe përputhjen me standardet ligjore.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen institucionet e pavarura të cilat kanë nxjerrë protokolle specifike për mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, dhe ato që nuk e kanë bërë këtë ende.

✔ Kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme	- Nuk kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme
1 Zyra e Rregullatorit për Energji	1 Radio Televizioni i Kosovës
2 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	2 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
3 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	3 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
	4 Akademia e Shkencave dhe i Arteve të Kosovës
	5 Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
	6 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
	7 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
	8 Agjencia Kosovare e Privatizimit
	9 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
	10 Akademia e Drejtësisë
	11 Institucioni i Avokatit të Popullit
	12 Komisioni i Pavarur i Mediave
	13 Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës
	14 Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
	15 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës
	16 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
	17 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
	18 Organi Shqyrtues i Prokurimit
	19 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
	20 Autoriteti i Aviacionit Civil

Tabela 34. Numri i institucioneve të pavarura që kanë nxjerrë protokolle specifike për ruajtjen e të dhënave personale të ndjeshme dhe i atyre që nuk kanë protokolle të tilla.

8.8 Kërkesat për këshilla drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Vetëm 7 institucione të pavarura kanë raportuar se kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërkohë, 16 institucione tjera kanë thënë se nuk kanë dërguar ndonjë kërkesë të tillë në AIP.

Kjo situatë edhe njëherë thekson rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit të institucioneve të pavarura për rolin kritik që luan AIP në mbrojtjen e të dhënave personale. Institucionet duhet të inkurajohen të kërkojnë këshilla dhe mbështetje për të siguruar që politikat dhe praktikat e tyre të jenë në përputhje me ligjin dhe të mbrojnë privatësinë e qytetarëve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar institucionet e pavarura të cilat kanë dërguar në AIP kërkesa për këshilla dhe ato që nuk kanë kërkuar asistencë të tillë.



Kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP



Nuk kanë dërguar kërkesa për Këshilla në AIP

1	Radio Televizioni i Kosovës	1	Organi Shqyrtues i Prokurimit
2	Komisioni i Pavarur i Mediave	2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
3	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	3	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
4	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	4	Akademia e Shkencave dhe i Arteve të Kosovës
5	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5	Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe 1Komplekseve Memoriale
6	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës	6	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
7	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	7	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
		8	Agjencia Kosovare e Privatizimit
		9	Zyra e Rregullatorit për Energji
		10	Akademia e Drejtësisë
		11	Institucioni i Avokatit të Popullit
		12	Autoriteti i Aviacionit Civil
		13	Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës
		14	Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
		15	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
		16	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Tabela 35. Numri i institucioneve të pavarura që kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP dhe ato që nuk kanë bërë kërkesa të tilla.

8.9 Kërkesat e qytetarëve për fshirjen e të dhënave personale

Sikurse tek shumica e institucioneve të tjera, asnjë institucion i pavarur nuk ka pranuar kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale, respektivisht për të zbatuar "të drejtën për t'u harruar".

Ky rezultat tregon një ndërgjegjësim të ulët të qytetarëve për të drejtën për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale, si dhe nevojën për fushata të vetëdijesimit për të drejtat e qytetarëve lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe për krijimin e mekanizmave të qartë që mundësojnë zbatimin e këtyre kërkesave. Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur institucionet e pavarura, të cilat nuk kanë pranuar kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga ana e qytetarëve.

 Kanë pasur kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale	 Nuk kanë pasur kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale
	1 Radio Televizioni i Kosovës
	2 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
	3 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
	4 Akademia e Shkencave dhe i Arteve të Kosovës
	5 Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
	6 Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
	7 Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
	8 Agjencia Kosovare e Privatizimit
	9 Zyra e Rregullatorit për Energji
	10 Akademia e Drejtësisë
	11 Institucioni i Avokatit të Popullit
	12 Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
	13 Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës
	14 Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
	15 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës
	16 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
	17 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
	18 Organi Shqyrtues i Prokurimit
	19 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
	20 Autoriteti i Aviacionit Civil
	21 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
	22 Komisioni i Pavarur i Mediave
	23 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Tabela 36. Numri i institucioneve të pavarura që kanë pranuar ose jo kërkesa për fshirjen e të dhënave personale të qytetarëve.

9.

**Zbatimi i ligjit për
mbrojtjen e të
dhënave personale
nga universitetet
publike**

9. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga universitetet publike

Universitetet publike mbledhin dhe ruajnë një sasi të madhe të të dhënave personale nga studentë, stafi akademik dhe administrativ. Mbrojtja e këtyre të dhënave është thelbësore për të siguruar që privatësia e individëve të respektohet dhe që të dhënat e këtyre subjekteve të mos keqpërdoren.

Sa i përket përgjigjeve të pranuar, të gjitha universitetet publike të Kosovës kanë ofruar përgjigje në kërkesat për qasje në dokumente publike.

9.1 Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

Në lidhje me caktimin e zyrtarëve përgjegjës, të gjitha universitetet publike, **përkatësisht 8 sosh, kanë raportuar se e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.**

Ky rezultat tregon një nivel të lartë të përmbushjes së obligimit ligjor nga universitetet publike në lidhje me caktimin e zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, ky rezultat reflekton një angazhim të lartë nga ana e universiteteve publike në zbatimin e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, duke rritur sigurinë e të dhënave personale të studentëve dhe stafit të tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar universitetet publike të cilat i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.



E kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale



Nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

1	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë	
2	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë	
3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren	
4	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë	
5	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë	
6	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjiilan	
7	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj	
8	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë	

Tabela 37. Numri i universiteteve publike që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato që nuk e kanë kryer ende këtë obligim.

9.2 Hartimi dhe publikimi i politikave të privatësisë

Vetëm 2 universitete publike i kanë hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë, ndërsa 6 prej tyre nuk i kanë hartuar/publikuar ende këto politika.

Ky rezultat reflekton se, megjithëse është bërë përparim në disa universitete, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kanë përmbushur ende këtë aspekt të rëndësishëm të transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke krijuar një boshllëk në mbrojtjen e të drejtave të studentëve dhe stafit në raport me privatësinë.

Nga sqarimet e ofruara, universitetet që ende nuk e kanë mbushur këtë detyrim, kanë thënë që janë në proces të finalizimit të këtij procesi në bashkëpunim me AIP-në.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet publike të cilat i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë, dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

**I kanë hartuar/
publikuar politikat e privatësisë**

1	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
2	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj

**Nuk i kanë hartuar/
publikuar politikat e privatësisë**

1	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë
2	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë
3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
4	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë
5	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë
6	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan

Tabela 38. Numri i universiteteve publike që nuk i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë dhe ato që e kanë përmbushur këtë obligim.

9.3 Trajnimi i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale

Vetëm 3 universitete publike kanë aprovuar se zyrtarët e tyre kanë ndjekur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, trajnime këto të organizuara nga AIP. Ndërkohë, 5 universitete të tjera kanë thënë se zyrtarët përgjegjës të tyre nuk kanë zhvilluar trajnime në lidhje me këtë fushë.

Këto rezultate tregojnë se në pjesën më të madhe të universiteteve ka mungesë të vetëdijes apo angazhimit të mjaftueshëm në këtë fushë të ndjeshme, duke reflektuar nevojën për përkushtim në ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet publike, zyrtarët e të cilëve kanë mbajtur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ata që nuk kanë mbajtur trajnime të tilla.

**Kanë kryer trajnime për mbrojtjen e të
dhënave personale**

1	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë
2	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan
3	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë

**Nuk kanë kryer trajnime për mbrojtjen e të
dhënave personale**

1	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj
2	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë
3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
4	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
5	Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë

Tabela 39. Numri i universiteteve publike, zyrtarët e të cilave kanë mbajtur trajnime ose jo në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

9.4 Nxjerrja e Rregullores për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Vetëm 3 universitete publike kanë deklaruar se kanë miratuar Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkaq, 3 universitete të tjera ende nuk e kanë nxjerrë këtë rregullore të rëndësishme, e cila siguron masa mbrojtëse për të dhënat personale në përputhje me ligjin.

Ky rezultat tregon se ka ende shumë punë për të bërë në drejtim të përmbushjes së standardeve për sigurinë dhe privatësinë e të dhënave në gjysmën e universiteteve që ende nuk i kanë nxjerrë rregulloret në fjalë.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet publike, zyrtarët e të cilëve kanë mbajtur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ata që nuk kanë mbajtur trajnime të tilla.

 E kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes	 Nuk e kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes
1 Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj	1 Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan
2 Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren	2 Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë
3 Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë	3 Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë
	4 Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
	5 Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë

Tabela 40. Numri i universiteteve publike që e kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe ato që ende nuk e kanë nxjerrë rregulloren e tillë.

9.5 Ankesat e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale

Asnjë nga universitetet publike të Kosovës nuk ka pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale në institucionet e tyre.

Ky rezultat tregon, në njërin anë, se mund të ketë një nivel të kënaqshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, apo në anën tjetër, se qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre në këtë fushë. Në një situatë të tillë, universitetet publike duhet të përqendrohen më shumë në ngritjen e vetëdijes dhe informimit të publikut për të drejtat e tyre, në mënyrë që qytetarët të jenë më aktivë në mbrojtjen e privatësisë së tyre dhe të ndjehen të inkurajuar të raportojnë shkeljet kur ato ndodhin.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet tek të cilat nuk ka pasur ankesa të regjistruara nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale.



Ka pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale



Nuk kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale

	1	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
	2	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë
	3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
	4	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë
	5	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë
	6	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan
	7	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj
	8	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë

Tabela 41. Numri i universiteteve publike që kanë pasur ose jo ankesa për mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarët.

9.6 Periudha e ruajtjes së të dhënave personale

Vetëm 3 universitete publike kanë periudha të përcaktuara të ruajtjes së të dhënave personale. Ndërkaq 5 institucione të tjera kanë thënë se nuk kanë ndonjë periudhë të ruajtjes së të dhënave personale të përcaktuar në institucionet e tyre.

Ky rezultat tregon se vetëm një numër i vogël universiteteve publike kanë marrë masa për të përcaktuar periudhat e ruajtjes së të dhënave personale, ndërsa shumica e këtyre universiteteve nuk kanë ndonjë strategji të qartë për këtë çështje. Si rezultat i kësaj, mos definimi i periudhave të ruajtjes mund të çojë në mbajtjen e të dhënave për një kohë të pacaktuar ose më gjatë sesa është e nevojshme.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet publike të cilat kanë të përcaktuara periudha të ruajtjes së të dhënave personale, dhe ato që nuk kanë afate të tilla.



Kanë periudha të përcaktuara të ruajtjes së të dhënave personale



Nuk kanë periudha të përcaktuara të ruajtjes së të dhënave personale

1	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë	1	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
2	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë	2	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë
3	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan	3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
		4	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë
		5	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj

Tabela 42. Numri i universiteteve publike që kanë përcaktuar periudha të ruajtjes së të dhënave personale dhe ata që ende nuk kanë përcaktuar afate të tilla.

9.7 Protokollet për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme

Vetëm 2 universitete publike kanë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, ndërsa 6 universitetet tjera kanë thënë se nuk kanë protokolle të tilla.

Ky rezultat ngrit shqetësime për sigurinë e të dhënave të ndjeshme në shumicën e universiteteve publike, duke treguar një mungesë të qasjes së strukturuar për të mbrojtur këto informacione të rëndësishme. Për të adresuar këtë problem, është e domosdoshme që universitetet të zhvillojnë dhe zbatojnë politika të qarta për mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, duke siguruar që i gjithë stafi administrativ të trajnohet për të njohur dhe zbatuar këto protokolle.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet publike të cilat kanë nxjerrë protokolle specifike për mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, dhe ato që nuk e kanë bërë këtë ende.



Kanë të përcaktuar protokolle për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme



Nuk kanë të përcaktuar protokolle për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme

1	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë	1	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
2	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë	2	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë
		3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
		4	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj
		5	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë
		6	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan

Tabela 43. Numri i universiteteve publike që kanë nxjerrë protokolle specifike për ruajtjen e të dhënave personale të ndjeshme dhe ato që ende nuk kanë nxjerrë protokolle të tilla.

9.8 Kërkesat për këshilla drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Vetëm 4 universitete publike kanë raportuar se kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërkohë, 4 universitete tjera kanë thënë se nuk kanë dërguar ndonjë kërkesë të tillë në AIP.

Ky rezultat mund të tregojë se gjysma e universiteteve kanë treguar bashkëpunim me AIP-në, duke kërkuar udhëzime për të siguruar përputhshmërinë e veprimeve të tyre me ligjin në fuqi dhe rregulloret e mbrojtjes së të dhënave personale. Në anën tjetër, do të ishte e dobishme për gjysmën e universiteteve që nuk kanë dërguar kërkesa për këshilla të konsiderojnë përfitimet që vijnë nga bashkëpunimi me një institucion si AIP, duke përfituar nga ekspertiza e këtij institucioni për të siguruar mbrojtje të plotë të të dhënave personale.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar universitetet publike të cilat kanë dërguar në AIP kërkesa për këshilla dhe ato që nuk kanë kërkuar asistencë të tillë nga AIP.



Kanë dërguar në AIP kërkesa për këshilla



Nuk kanë dërguar në AIP kërkesa për këshilla

1	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë	1	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë
2	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë	2	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë
3	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë	3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
4	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan	4	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj

Tabela 44. Numri i universiteteve publike që kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP dhe ato që edhe nuk kanë dërguar kërkesa të tilla.

9.9 Kërkesat e qytetarëve për fshirjen e të dhënave personale

Asnjë universitet publik nuk ka pranuar kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale, respektivisht për të realizuar "të drejtën për t'u harruar".

Sikurse në rastet e institucioneve të tjera, ky rezultat mund të shihet si mungesë e ndërgjegjësimit të mjaftueshëm nga ana e qytetarëve për këtë të drejtë, si dhe mund të tregoj një mungesë të praktikave të duhura nga universitetet për të informuar individët mbi mundësitë e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përgjithësi, rezultatet e tilla nënvizojnë nevojën për të organizuar fushata ndërgjegjësuese për të ngritur vetëdijen e qytetarëve për të drejtën e privatësisë, përfshirë edhe të drejtën për fshirjen e të dhënave personale.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar universitetet publike tek të cilat nuk ka pasur kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale.



Kanë pranuar kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga qytetarët



Nuk kanë pranuar kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga qytetarët

	1	Universiteti " Haxhi Zeka" - Pejë
	2	Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë
	3	Universiteti "Ukshin Hoti" - Prizren
	4	Universiteti i Shkencave të Aplikuara - Ferizaj
	5	Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë
	6	Universiteti "Fehmi Agani" - Gjakovë
	7	Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë
	8	Universiteti "Kadri Zeka" – Gjilan

Tabela 45. Universitet publike të cilat nuk kanë pasur kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga ana e qytetarëve.

10.

Zbatimi i ligjit për
mbrojtjen e të
dhënave personale
nga ndërmarrjet
publike

10. Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga ndërmarrjet publike

Ndërmarrjet publike në shumë sektorë (energji, ujë, shërbime sociale etj.), përpunojnë sasi të mëdha të të dhënave personale, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve nëse të njëjtat keqpërdoren.

Prandaj, mbrojtja e të dhënave personale në ndërmarrjet publike është thelbësore për ruajtjen e privatësisë së qytetarëve, duke siguruar që këto të dhëna të mos përdoren për qëllime të paligjshme.

Nga 10 ndërmarrjet publike të Kosovës tek të cilat FOL është drejtuar përmes kërkesave për qasje në informacione publike, përgjigje kemi pranuar vetëm nga 6 ndërmarrje publike, ndërsa 4 sosh nuk janë përgjigjur.⁹

10.1 Caktimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale

Në lidhje me caktimin e zyrtarëve përgjegjës, vetëm 1 ndërmarrje publike ka raportuar se nuk e ka caktuar ende zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga sqarimet e ofruara, kjo ndërmarrje, përkatësisht *Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave* ka thënë se mungesa e bordit të drejtorëve u ka sjellë sfida në funksionimin dhe planifikimin e proceseve të rëndësishme në këtë ndërmarrje. Si rrjedhojë e kësaj, sipas tyre, ende nuk është caktuar zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, obligim që do të realizohet shumë shpejtë nga menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje.

Ky rezultat sugjeron se shumica e ndërmarrjeve publike kanë ndërmarrë hapa konkretë për të respektuar kërkesat ligjore për caktimin e një zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale, gjë që është një shenjë pozitive e përputhshmërisë me kërkesat e ligjit në fuqi. Pra, në përgjithësi ndërmarrjet publike janë treguar të përgjegjshme për të siguruar kushtet minimale për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve.

⁹ Ndërmarrjet publike të cilat nuk janë përgjigjur në kërkesat e dërguara nga FOL janë: Kompania Energjetike e Kosovës; NPQ "Aeroporti i Gjakovës", SH.A.; Infrastruktura e Hekurudhave -INFRAKOS, Sh.A; si dhe Aeroporti Nderkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari".

Në tabelën e mëposhtme janë listuar ndërmarrjet publike të cilat i kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

✔ E kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale	✖ Nuk e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale
1 Posta e Kosovës	1 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
2 Telekom i Kosovës	
3 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos	
4 Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"	
5 Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut	

Tabela 46. Ndërmarrjet publike që e kanë caktuar zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

10.2 Hartimi dhe publikimi i politikave të privatësisë

Vetëm 1 ndërmarrje publike i ka hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë, ndërsa 5 prej tyre nuk i kanë hartuar/publikuar ende këto politika. Në përgjithësi, ndërmarrjet kanë sqaruar se janë ende në proces të hartimit të këtyre politikave.

Ky rezultat reflekton se, ndërmarrjet publike kanë ende shumë punë për të bërë në drejtim të përmbushjes së standardeve ligjore dhe për të garantuar transparencën për qytetarët.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet ndërmarrja publike që i ka hartuar/publikuar politikat e privatësisë, dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

✔ I kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë	✖ Nuk i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë
1 Telekom i Kosovës	1 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
	2 Posta e Kosovës
	3 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos
	4 Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"
	5 Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut

Tabela 47. Numri i ndërmarrjeve publike që nuk i kanë hartuar/publikuar politikat e privatësisë dhe ato që e kanë përmbushur këtë obligim.

10.3 Trajnimi i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale

Vetëm 1 ndërmarrje publike ka pohuar se zyrtari përgjegjës i kësaj ndërmarrjeje ka ndjekur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, ndërsa 5 ndërmarrjet tjera kanë thënë se zyrtarët përgjegjës të tyre nuk kanë zhvilluar asnjëherë trajnime në lidhje me këtë fushë.

Ky rezultat tregon një mungesë të përgjithshme të trajnimit dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale në shumicën e ndërmarrjeve publike. Rrjedhimisht, duke ditur rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale në mënyrë efektive, ndërmarrjet publike duhet të angazhohen seriozisht për të investuar në trajnime të tilla për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen ndërmarrjet publike, zyrtarët e të cilëve kanë mbajtur trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ata që nuk kanë mbajtur trajnime të tilla.



 Kanë zhvilluar trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale	 Nuk kanë zhvilluar trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale
1 Telekomi i Kosovës	1 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
	2 Posta e Kosovës
	3 Hekurudhat e Kosovës Trainkos
	4 Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"
	5 Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut

Tabela 48. Numri i ndërmarrjeve publike zyrtarët e të cilave kanë mbajtur trajnime ose jo në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

10.4 Nxjerrja e Rregullores për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Vetëm 1 ndërmarrje publike ka deklaruar se ka nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkaq, 5 ndërmarrje të tjera ende nuk e kanë nxjerrë këtë rregullore të rëndësishme, e cila siguron masa mbrojtëse për të dhënat personale në përputhje me ligjin.

Ndërmarrjet të cilat nuk e kanë përmbushur këtë obligim kanë sqaruar se janë në proces të hartimit të rregullores, e deri atëherë do të zbatojnë rregullativën ligjore.

Rregullorja është një dokument kyç që përcakton masat e nevojshme për të siguruar që të dhënat personale të trajtohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e privatësisë. Mungesa e miratimit të kësaj rregulloreje nga shumica e ndërmarrjeve publike tregon një neglizhencë të mundshme ndaj kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen universitetet publike të cilat kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe të mbrojtjes, dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur obligimin e tillë.



Kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale



Nuk kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale

1	Telekomi i Kosovës	1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
		2	Posta e Kosovës
		3	Hekurudhat e Kosovës Trainkos
		4	Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"
		5	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut

Tabela 49. Numri i ndërmarrjeve publike që kanë nxjerrë Rregulloren për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe ato që ende nuk e kanë përmbushur këtë obligim.

10.5 Ankesat e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave personale

Asnjë ndërmarrje publike nuk ka pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky rezultat mund të tregojë një nivel të kënaqshëm të mbrojtjes së të dhënave personale nga ndërmarrjet publike, ku qytetarët ndihen të sigurt në trajtimin e informacionit të tyre. Nga ana tjetër, ky rezultat gjithashtu mund të tregoj se qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Rrjedhimisht, kjo mund të sugjerojë nevojën për fushata ndërgjegjësimi që informojnë individët për të drejtat e tyre dhe procedurat për të raportuar shkeljet e mundshme.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar ndërmarrjet publike të cilat nuk kanë pasur ankesa për mbrojtjen e të dhënave nga qytetarët.



 Kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale	 Nuk kanë pasur ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale
	1 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
	2 Posta e Kosovës
	3 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos
	4 Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"
	5 Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
	6 Telekom i Kosovës

Tabela 50. Numri i ndërmarrjeve publike që kanë pasur ose jo ankesa për mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarët.

10.6 Periudha e ruajtjes së të dhënave personale

Vetëm 1 ndërmarrje publike ka deklaruar se kanë periudha të përcaktuara të ruajtjes së të dhënave personale. Ndërkaq 5 ndërmarrje të tjera kanë thënë se nuk kanë ndonjë periudhë të ruajtjes së të dhënave personale të përcaktuar qartë në ndërmarrjet e tyre.

Ky rezultat tregon se vetëm 1 ndërmarrje publike ka marrë masa për të përcaktuar periudhat e ruajtjes së të dhënave personale, ndërsa pjesa më e madhe e ndërmarrjeve nuk kanë afate të qarta se sa do të mbahen të ruajtura të dhënat personale.

Mungesa e periudhave të përcaktuara për ruajtjen e të dhënave personale në 5 ndërmarrje sugjeron një mungesë të praktikave të qarta dhe të dokumentuara për menaxhimin e të dhënave personale. Kjo rrezikon mbajtjen e informacionit për një kohë më të gjatë sesa është e nevojshme, duke rritur rrezikun e shkeljeve të privatësisë.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen ndërmarrjet publike cilat kanë të përcaktuara periudha të ruajtjes së të dhënave personale, dhe ato që nuk kanë afate të tilla.



 Kanë përcaktuar periudha të ruajtjes së të dhënave personale	 Nuk kanë përcaktuar periudha të ruajtjes së të dhënave personale
1 Telekomi i Kosovës	1 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
	2 Posta e Kosovës
	3 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos
	4 Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci".
	5 Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut

Tabela 51. Numri i ndërmarrjeve publike që kanë të përcaktuara ose jo periudha të ruajtjes së të dhënave personale.

10.7 Protokollet për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme

Vetëm 3 ndërmarrje publike kanë deklaruar se kanë nxjerrë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, ndërsa 6 ndërmarrjet tjera kanë thënë se nuk kanë protokolle të tilla.

Ndonëse gjysma e ndërmarrjeve publike e kanë përmbushur këtë obligim, ky rezultat vë në pikëpyetje sigurinë e të dhënave të ndjeshme në gjysmën e ndërmarrjeve publike, duke treguar një mungesë të qasjes së strukturuar për të mbrojtur këto informacione të rëndësishme.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihen ndërmarrjet publike të cilat kanë nxjerrë protokolle specifike për mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme, dhe ato që nuk e kanë bërë këtë ende.



Kanë nxjerrë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme



Nuk kanë nxjerrë protokolle specifike për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme

1	Telekomi i Kosovës	1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
2	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut	2	Posta e Kosovës
3	Hekurudhat e Kosovës Trainkos	3	Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"

Tabela 52. Numri i ndërmarrjeve publike që kanë nxjerrë protokolle specifike për ruajtjen e të dhënave personale të ndjeshme dhe ato që nuk e kanë përmbushur këtë obligim

10.8 Kërkesat për këshilla drejtuar Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Vetëm 2 ndërmarrje publike kanë raportuar se kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale.

Numri i ulët i kërkesave për këshilla tregon se shumica e ndërmarrjeve publike nuk janë aktive në kërkimin e ndihmës dhe udhëzimeve nga AIP për menaxhimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Rritja e angazhimit të ndërmarrjeve në këtë drejtim do të ndihmonte në forcimin e marrëdhënies midis AIP-së dhe ndërmarrjeve, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar ndërmarrjet publike të cilat kanë dërguar në AIP kërkesa për këshilla dhe ato që nuk kanë kërkuar asistencë të tillë.



Kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale



Nuk kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale

1	Telekomi i Kosovës	1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
2	Posta e Kosovës	2	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
		3	Hekurudhat e Kosovës Trainkos
		4	Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"

Tabela 53. Numri i ndërmarrjeve publike që kanë dërguar kërkesa për këshilla në AIP për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ato që nuk kanë kërkuar këshilla të tilla.

10.9 Kërkesat e qytetarëve për fshirjen e të dhënave personale

Asnjë ndërmarrje publike nuk ka pranuar kërkesa nga qytetarët për fshirjen e të dhënave personale, respektivisht për të realizuar "të drejtën për t'u harruar".

Si në shumicën e institucioneve të tjera, mungesa e kërkesave nga qytetarët për t'a realizuar këtë të drejtë tregon se ka një nevojë të qartë për fushata edukative që informojnë qytetarët mbi të drejtat e tyre dhe mënyrat si mund t'i zbatojnë ato.

Rrjedhimisht, është nevojë imanente rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtat e tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, e në veçanti për "të drejtën për t'u harruar". Kjo do të ndihmojë në krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të mbrojtur për të dhënat personale të individëve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar ndërmarrjet publike, tek të cilat nuk ka pasur kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga qytetarët.



Kanë pranuar kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga qytetarët



Nuk kanë pranuar kërkesa për fshirjen e të dhënave personale nga qytetarët

	1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
	2	Posta e Kosovës
	3	Hekurudhat e Kosovës - Trainkos
	4	Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci"
	5	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
	6	Telekomi i Kosovës

Tabela 54. Ndërmarrjet publike të cilat kanë pasur ose jo kërkesa për fshirjen e të dhënave personale.

11. Pasqyra e ankeseve dhe masave të marrura nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (janar 2022 – nëntor 2024)

Në këtë kapitull do të trajtohen në mënyrë specifike ankesat e paraqitura në AIP në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe masat e ndërmarra nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) gjatë periudhës janar 2022 – nëntor 2024.

Synimi i këtij kapitulli është të analizojë dhe krahasojë dinamikën e ankeseve, llojin e shkeljeve të raportuara, institucionet ndaj të cilave janë parashtruar ankesat, si dhe veprimet ndëshkimore të ndërmarra nga AIP gjatë kësaj periudhe gati trevjeçare.

Kjo analizë ofron një pasqyrë të hollësishme për mënyrën se si janë zhvilluar trendet e raportimit të shkeljeve të të dhënave personale, duke theksuar progresin dhe sfidat në zbatimin e ligjit. Në veçanti, raporti shqyrton vendimmarrjen dhe shqiptimin e gjobave kundërvajtëse.

11.1 Numri i ankeseve për mbrojtje të të dhënave personale

Në periudhën janar 2022 - nëntor 2024, AIP ka trajtuar një numër të konsiderueshëm ankeshash, përkatësisht 380 ankesa lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus të veçantë në përpunimin e të dhënave pa pëlqim, shkeljet nga sistemi i kamerave të vëzhgimit, si dhe shpërndarja e të dhënave personale pa autorizim.

Të dhënat e mëposhtme paraqesin ndryshimet në numrin e ankeseve gjatë periudhës janar 2022 – nëntor 2024.

Periudha	Numri i ankeseve
janar – dhjetor 2022	145
janar – dhjetor 2023	121
janar – nëntor 2024	114

Tabela 55. Numri i ankeseve të bëra gjatë periudhës janar 2022 - nëntor 2024.

Gjatë vitit 2022, AIP ka pranuar gjithsej 145 ankesa. Në krahasim me vitin 2021, ka pasur një rritje të dukshme të numrit të ankesave, ku në vitin 2021 ishin parashtruar vetëm 35 ankesa (10 ndaj institucioneve publike dhe 25 ndaj institucioneve private).

Ndaj institucioneve publike ka pasur gjithsej 32 ankesa, ndërsa ndaj institucioneve private 113 ankesa.

Gjatë vitit 2023, AIP ka pranuar 121 ankesa të reja, si dhe 36 ankesa të bartura nga viti paraprak, duke arritur gjithsej 157 ankesa për shqyrtim. Agjencia ka arritur që brenda vitit 2023, nga numri i përgjithshëm i ankesave si më lartë, 142 prej tyre t'i mbyll në proces administrativ nëpërmjet vendimmarrjes, ndërsa 15 t'i bartë për vitin vijues.

Në periudhën janar-nëntor 2024, AIP ka pranuar gjithsej 118 ankesa nga subjekte publike dhe private lidhur me shkeljen e të dhënave personale. Nga ky numër, 100 ankesa janë mbyllur dhe 18 janë ende në proces të shqyrtimit.

Gjatë kësaj periudhe, 70 ankesa janë paraqitur ndaj institucioneve private, 34 ndaj institucioneve publike, ndërsa 14 ndaj personave fizik.

11.2 Vendimet e agjencisë dhe shqiptimi i gjobave kundërvajtëse

Gjatë periudhës janar 2022 – nëntor 2024, AIP ka marrë gjithsej 639 vendime lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe ka shqiptuar 15 gjoba kundërvajtëse për shkelje të ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me vlerë 261,000.00 euro.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i vendimeve të marra nga AIP në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë periudhës 2022-2024.

Periudha	Numri i vendimeve
janar – dhjetor 2022	172
janar – dhjetor 2023	178
janar – nëntor 2024	289

Tabela 56. Numri i vendimeve të nxjerra nga AIP gjatë periudhës janar 2022-nëntor 2024.

Gjatë vitit 2022, AIP ka marrë 172 vendime, nga të cilat 23 vendime kanë qenë ndaj institucioneve publike, ndërsa 149 vendime ndaj institucioneve private.

Në mesin e këtyre vendimeve të nxjerra, 8 prej tyre kanë qenë vendime për shqiptim të gjobave kundërvajtëse. Gjobat kundërvajtëse të shqiptuara kanë arritur vlerën totale 169,000.00 euro. Këto gjoba janë shqiptuar ndaj subjekteve si më poshtë:

- 4 ndaj institucioneve publike dhe
- 4 ndaj institucioneve private.

Gjatë vitit 2023, AIP ka marrë gjithsej 178 vendime, 21 ndaj institucioneve publike, 132 ndaj institucioneve private, 11 ndaj partive politike, 1 ndaj OJQ dhe 5 ndaj personave fizik.

Nga këto vendime, 4 prej tyre janë vendime për shqiptim të gjobave kundërvajtëse, me një vlerë totale prej 32,000.00 euro. Këto gjoba janë shqiptuar ndaj subjekteve si më poshtë:

- 3 gjoba ndaj subjekteve private;
- 1 gjobë ndaj një partie politike.

Gjatë periudhës janar – nëntor 2024, AIP ka marrë 111 vendime (sipas ankesës), si dhe 178 vendime nga inspektimet sipas detyrës zyrtare. Në mesin e këtyre vendimeve, AIP ka shqiptuar 3 gjoba kundërvajtëse ndaj institucioneve publike në vlerë prej 60.000 euro, dhe atë:

- 20,000 euro për publikimin e të dhënave personale të ndjeshme nga Komuna e Gjakovës,
- 20,000 euro ndaj KEDS dhe
- 20,000 euro ndaj KRU "Prishtina" për mos-marrjen e masave të duhura të sigurisë gjatë shpërndarjes së faturave tek konsumatorët (subjektet e të dhënave).

Si përfundim, në periudhën janar 2022 – nëntor 2024, AIP ka pasur një fluks të konsiderueshëm ankesash dhe të vendimmarrjes, duke reflektuar angazhim të vazhdueshëm në forcimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Rritja e numrit të ankesave tregon një ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve dhe institucioneve për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjobat kundërvajtëse dhe vendimet e AIP-së kanë kontribuar në forcimin e masave të sigurisë dhe në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve për ruajtjen e të dhënave personale.

Sidoqoftë, sfidat mbeten veçanërisht në lidhje me përputhshmërinë e plotë të veprimeve të institucioneve me kërkesat e ligjit dhe zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale. Për të arritur një mbrojtje efektive dhe të qëndrueshme të të dhënave personale, është e nevojshme që AIP të vazhdojë të forcojë mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi përdorimin e të dhënave, ndërkohë që duhet përmirësuar edhe vetëdijesimi i institucioneve dhe individëve për të respektuar kërkesat e ligjit. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar dhe të qëndrueshme mund të arrihet një mbrojtje më efikase e të dhënave personale dhe të arrihet mbrojtja e të drejtave të qytetarëve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

12. Rekomandime

Në përfundim të këtij raporti, bazuar në analizën e detajuar të situatës aktuale të mbrojtjes së të dhënave personale në institucionet publike të Kosovës, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- **Të gjitha institucionet publike të angazhohen për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, të drejtat në dispozicion, si dhe të organizojnë trajnime të rregullta për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të tyre.**

- **Institucionet publike të rishikojnë dhe përmirësojnë rregullisht politikat dhe procedurat e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale, duke marrë parasysh ndryshimet në ligj dhe zhvillimet teknologjike.**

- **Institucionet që ende nuk kanë hartuar dhe publikuar politikat e privatësisë duhet të përshpejtojnë këtë proces, duke siguruar që këto politika të jenë të qarta dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët.**

- **Institucionet publike të zhvillojnë dhe miratojnë protokolle të qarta për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme, për të siguruar që këto të dhëna të trajtohen me kujdesin e duhur.**

- **Të gjitha institucionet të nxjerrin Rregulloren për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale, duke siguruar një kornizë të qartë për veprimet që duhet të ndërmerren në rastin e shkeljeve.**

- **Të gjitha institucionet publike të përcaktojnë qartë periudhat për ruajtjen e të dhënave personale, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat ligjore.**

- **Të krijohen mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke përfshirë auditime të rregullta dhe raporte përkatëse.**

Shtojca

PYETËSORI NË LIDHJE ME MBROJTJEN E TË DHËNAVE PËRSONALE NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Në kuadër të përpjekjeve për të vlerësuar dhe përmirësuar praktikën e mbrojtjes së të dhënave personale, Lëvizja FOL ka hartuar këtë pyetësor me qëllim të mbledhjes së informacioneve mbi përputhshmërinë e praktikave të institucioneve me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përgjigjet tuaja do të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë gjendjen aktuale dhe të identifikojmë fushat që kërkojnë përmirësim.

Prandaj kërkojmë nga ju që të plotësoni këtë pyetësor me informacione të sakta dhe për çdo pyetje që kërkon bashkëngjitjen e linqeve, ju lutemi të siguroheni që ato të jenë të qasshme dhe të vlefshme.

Përgjigjet tuaja janë thelbësore për hulumtimin tonë dhe ne ju falënderojmë paraprakisht për kohën dhe bashkëpunimin tuaj!

Ky pyetësor realizohet nga Lëvizja FOL në kuadër të projektit "Gardianët e të Dhënave: Forcimi i Politikave të Privatësisë dhe Ndërgjegjësimi në Institucionet Publike", përmes Human Rightivism që mbështetet nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë përmes CDF.

1. Cilin institucion përfaqësoni?

2. A ka caktuar institucioni juaj zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale?

Nëse Po, ju lutem vendosni linkun e publikuar me kontaktet e zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në rubrikën më poshtë

Nëse Jo, ju lutemi sqaroni shkaqet në rubrikën më poshtë

3. A ka hartuar dhe publikuar institucioni juaj politikën e privatësisë ?

Nëse Po, ju lutemi vendosni linkun e publikimit në rubrikën më poshtë

Nëse Jo, ju lutemi sqaroni shkaqet në rubrikën më poshtë

4. A ka ndjekur trajnime zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale në institucionin tuaj?

- Po
- Jo

Nëse po ju lutem përshkruani trajnimin dhe organizatorin

5. A ka nxjerrë institucioni juaj Rregulloren për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale në Institucionin tuaj?

- Po
- Jo

Nëse Po, ju lutem vendosni linkun në rubrikën më poshtë

Nëse Jo, ju lutemi sqaroni shkaqet në rubrikën më poshtë

6. A ka pasur institucioni juaj ankesa nga qytetarët për mbrojtjen e të dhënëve personale ?

- Po
- Jo

Nëse po, ju lutemi përshkruani numrin e ankesave dhe subjektin e tyre në rubrikën më poshtë

7. A ka ndonjë periudhë të ruajtjes së të dhënave personale të përcaktuar qartë në institucionin tuaj?

- Po
- Jo

Nëse po, ju lutemi përshkruani periudhat e ruajtjes dhe politikën përkatëse në rubrikën më poshtë

8. A ka ndonjë protokoll specifik për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme (p.sh., të dhënat shëndetësore, të dhënat financiare) në institucionin tuaj?

- Po
- Jo

Nëse po, ju lutemi përshkruani masat mbrojtëse të zbatuara në rubrikën më poshtë.

9. A ka drejtuar institucioni juaj kërkesa në Agjencinë për Informim dhe Privatësi për mbrojtjen e të dhënave personale?

- Po
- Jo

Nëse po, ju lutemi përshkruani numrin e kërkesave dhe subjektet e këshillave në rubrikën më poshtë.

10. A kanë dërguar qytetarët ndonjë kërkesë për fshirjen e të dhënave personale, respektivisht për "të drejtën për tu harruar"?

- Po
- Jo

Nëse Po, cilët kanë qenë hapat e ndërmarrë nga institucioni juaj

JU FALEMINDERIT!

